

MEDIKAMENTET

1. Medikamentet janë:
 - a. Substanca që ndryshojnë strukturën e trupit
 - b. Substanca që ndryshojnë funksionin e organeve
 - c. Substanca që ndërhyjnë në funksionin e gjakut
 - d. Substanca që përdoren për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve

2. Medikamente të përshkruara në recetë janë preparate të cilat:
 - a. Mund të blihen në farmaci pa përshkrimin e mjekut
 - b. Dobësojnë bakteriet dhe luftojnë infeksionet
 - c. Mund të shiten në farmaci vetëm me recetën e mjekut
 - d. Parandalojnë reaksionet alergjike

3. Medikamentet ose barnat e sigurta që mund të merren pa recetë janë:
 - a. OTC (Over The Counter Medications)
 - b. ATC (Anatomiko Terapeutik Kimik)
 - c. ICD Code
 - d. ICD Nursing Diagnoses Code

4. Vaksina është një medikament i llojit:
 - a. Antibiotik që vret bakteriet e rezikshme
 - b. Antidepresiv
 - c. Sedativ
 - d. Preparat nga germe të dobësuar ose të ngordhura që nxisin prodhimin e antikorpeve.

5. Cila është temperatura ideale e ruajtjes së vaksinave të inaktivizuara:
 - a. 10 - 15 gradë Celcius
 - b. -50 – -10 gradë Celcius
 - c. 2 – 8 gradë Celcius
 - d. -5 – 0 gradë Celcius

6. Cilët barna veprojnë në uljen e Hipertensionit Arterial:
 - a. Antimetabolikët
 - b. Antiinflamatorët josteroidë
 - c. Antihipertensivët
 - d. Antiinfektivët

7. Barbituratet janë:
 - a. Sedative te forte qe japin ndjenjen e relaksit
 - b. Gjumedhënes të moderuar
 - c. Hypnotike te fuqishëm
 - d. Qetesues të ankthit

8. Cilët barna veprojnë në prishjen e zinxhirit të Acidit Nukleik dhe Sintezën e proteinave duke shkaktuar imunosupresion dhe shkatërrim të qelizave kanceroze
 - a. Cikloplegjikët
 - b. Kalci Bllokuesit
 - c. Cytostatikët
 - d. Androgjenët

9. Vazokonstriktorët përdoren në zgjerimin e diametrit të enëve të gjakut, angina pectoris dhe Hipertension:
 - a. E vërtetë
 - b. E gabuar

10. Cilët barna përdoren për lehtësimin e spazmave muskulare:
 - a. Salycilatet
 - b. Sedativët
 - c. Relaxantët
 - d. Relaxantët myo-skeletor

11. Cilët barna veprojnë në veshka duke eliminuar kripërat dhe ujin nga organizmi:
 - a. Ekspektorantët
 - b. Estrogjenët
 - c. Diuretikët
 - d. Antikoagulantët

12. Cilët barna përdoren për të nxitur rritjen e skeletit tek femijët dhe plotësuar defiçencat e Hormonit të rritjes tek të rriturit:
 - a. Gonadotropinat
 - b. Fibrinolitikët
 - c. Hemostatikët
 - d. Zëvendësuesit e Hormonit të Rritjes GHR

13. A mund të administrohen sëbashku Barbituratet me Opiatet
 - a. E gabuar
 - b. E vërtetë

- c. Nuk ka evidenca
14. Një pacient duhet të marrë 800 ml serum për 8 orë me sistemin me faktor 20 pika/ml. Sa pika për minutë duhet që infermierja të rregullojë marrjet:
- 25 pika /min
 - 33 pika/min
 - 40 pika/min
 - 45 pika/min
15. Kur kryen një injeksion IM (intra-muskular) infermieri duhet të drejtojë agën në muskul në këndin:
- 15°
 - 30°
 - 45°
 - 90°
16. Cilat nga praktikatat ose procedurat kërkon asepti kirurgjikale?
- Larja e duarve
 - Irrigimi i tubit Nazo-Gastrik
 - Vendosja e kateterit IV (Intra-venoz)
 - Irrigimi i kolonostomisë
17. Infermieri e di se medikamentet mund të administrohen në më shumë se sa një rrugë. Cila rrugë administrimi siguron përgjigjen më të shpejtë nga pacienti.
- Orale
 - Intra muskulare
 - Sub linguale
 - Sub cutane
18. Cili nga komplikacionet e mëposhtëme nuk mund të ndodhë gjatë një terapie IV:
- Edeme Pulmonare
 - Embolizëm
 - Infeksion
 - Flebit
 - Aspirimi
19. Nëse gjatë transfuzionit të gjakut shfaqen shenja të reaksionit, përgjigja e menjehershme e infermierit do të ishte:
- Të kontaktoje me laboratorin e gjakut
 - Të therrasë menjëherë mjekun
 - Të reduktojë pikat e transfuzionit
 - Të ndalojë transfuzionin
20. Transfuzioni i gjakut dhe plazmës fillohet me pika të ngadalta në mënyrë që:
- Të evitohet mbingarkesa e sistemit vaskular

- b. Të evitohet hipotermia
 - c. Të vlerësohet përgjigja e pacientit ndaj perfuzionit
 - d. Të parandalohet formimi i tromboflebitit
21. Mjeku urdhëron transfusion gjaku për një pacient. Infermieri duhet të hapë rrugën venoze duke vendosur pajisjen IV me numër?
- a. 23G
 - b. 21G
 - c. 18G
 - d. 25G
22. Mjeku urdhëron një injeksion IM për një pacient. Cili faktor mund të ndikojë në shpejtësinë e përthithjes së medikamentit nga vendi i injektimit IM?
- a. Toni muskolor
 - b. Fortësia muskulare
 - c. Qarkullimi në vendin e injektimit
 - d. Sasia e dhjavit në vendin e injektimit
23. Një infermiere po i mëson një pacienti se si të injektojë insulinën subcutane. Cili do të ishte vendi më i përshtatshëm për t'u përdorur për injektim?
- a. M. Deltoid
 - b. Rectus femoris
 - c. Vastus lateralis
 - d. Pjesa anteriore e femurit
24. Mjeku urdhëron një injeksion diltiazemhydrochloride (Cardizem) I / V in bolus, për një pacient me fibrilacion atrial të padominuar. Çfarë duhet të bëjë infermieri përpara se të administrojë medikamentin in bolus intravenoz?
- a. Spirojë me kujdes kateterin I/V për të kontrolluar për kthim të gjakut
 - b. Vendos linjën I/V në krahun tjetër
 - c. Ngrohë medikamentin në temperaturën e dhomës
 - d. Vendosë llastikun në krah që ta përdorë për injeksionin
25. Cila është mënyra më e mirë që një infermier mund të përdorë për të përmirësuar bashkëpunimin e pacientit me orarin e përshkruar për të marrë medikamentet?
- a. Inkurajon pacientin që të punësojë një infermiere në shtëpi
 - b. I jep të gjitha udhëzimet së paku 3 herë në ditë
 - c. Ndryshon orarin e administrimit në intervale më të mëdha kohe
 - d. Krijon orarin më të thjeshtë të mundshëm të marrjes së medikamenteve për pacientin.
26. Përpara se të administrojë dozën e darkës të medikamentit të përshkruar, infermieri i turnit të dytë gjen një shiringë me medikament të pashkruar në komodinën e pacientit. c'farë duhet të bëjë infermieri?
- a. Të hedhë shiringën për të shmangur ndonjë gabim medikamentoz
 - b. Të marrë nga farmacia një etiketë për ta vendosur në shiringë

- c. Të përdorë shiringën sepse duket që përmban të njëjtin mjekim që infermierja po përgatitet t'ia injektojë pacientit
 - d. Të telefonojë infermierën e mëngjesit për të verifikuar përmbajtjen e shiringës.
27. Një infermier po i jep medikamentin një pacienti. Pacienti i thotë se zakonisht kokrra që ajo merr ka ngjyrë të bardhë, jo të verdhë si ajo që po i jep infermieri. Ç'farë duhet të bëjë së pari infermieri?
- a. T'i thotë pacientit se tableta e bardhë duhet të ketë qënë nga një prodhues tjetër farmaceutik
 - b. Të risigurojë pacientin se tableta e bardhë është ajo e duhura
 - c. Të mbajë medikamentin dhe të njoftojë mjekun
 - d. Të kontrollojë përsëri emrin e pacientit dhe medikamentin që po administron
28. Një infermiere po administron një injeksion IM (intra muskular). Pasi kryen injeksionin infermierja duhet:
- a. Të vendosë kapuçin e ages dhe ta hedhë atë në ndonjë kosh për mbetjet spitalore
 - b. Të vendosë kapuçin e ages dhe ta hedhë në një kuti që nuk shpohet nga agja
 - c. Të hedhë shiringën pa kapuç në një kuti të paçpueshme
 - d. Të thyejë agen dhe ta hedhë me gjithë shiringë me ndonjë kosh për mbetje spitalore
29. Një pacient i shtruar në spital po ushqehet me tub nazogastrik me anë të të cilit merr edhe medikamentet PO. Gjatë ushqyerjes bolus pacienti vomit (vjell) dhe fillon të mbytet. Cili është veprimi më i përshtatshëm që duhet të ndër marrë infermieri?
- a. Pastron rrugët ajrore të pacientit
 - b. Qetëson pacientin
 - c. Fillon ringjalljen kardio - pulmonare
 - d. Ndalon ushqyerjen dhe heq tubin nazogastrik
30. Mjeku ka përshkruar Morphine, 4 mg. IV, çdo 2 orë për dhimbje tek një pacient i hospitalizuar. Pacienti refuzon të marrë injeksionin. Cili do të ishte veprimi më i përshtatshëm infermieror?
- a. Administrimi i medikamentit sipar urdhërit të mjekut
 - b. I telefonon mjekut për të mundësuar marrjen orale të medikamentit
 - c. Nuk aplikon medikamentin deri sa pacienti të kuptojë rëndësinë e tij
 - d. I shpjegon që nuk ka medikamente të tjera për t'i dhënë deri sa pacienti të marrë medikamentin kundër dhimbjes që ka përshkruar mjeku
31. Një pacient po merr Furosemide (Lasiks), 40 mg, PO, 2 herë në ditë. Në planin e kujdesit infermieri duhet të theksojë mësimdhënien rreth rëndësisë së konsumimit të:
- a. Perimeve të freskëta
 - b. Bananes dhe portokalleve
 - c. Qumësht pa yndyrë
 - d. Pure me miell misri

32. Një pacient nuk ka urinuar që nga koha kur hyri në sallën e operacionit për ndërhyrje të kryer 8 orë më parë. Cili do të ishte veprimi i parë infermieror në këtë rast?
- Telefonojë mjekut për të raportuar gjëndjen
 - Kataterizon pacientin
 - Vlerëson pacientin për mbushjen e fshikzës urinare
 - I thotë pacientit të përkulet dhe të përpiqet të urinojë
33. Kur po kontrollon pacientët, një infermier shikon se një pacient po merr solucionin e gabuar IV. Përgjigja e menjëhershme infermierore do të jetë?
- Heq kateterin venoz dhe telefonon mjekun
 - Shkruan një raport ku përshkruan incidentin
 - Ngadalëson shpejtësinë e infuzionit dhe vendos solucionin e duhur
 - Pret deri sa të mbarojë solucioni i vendosur për të vendosur më pas solucionin e duhur
34. Infermieri është gati që t'i vendosë supostin paracetamol një pacienti. Pacienti ka diarre dhe është në banjë. Veprimi më i përshtatshëm infermieror në këtë situatë do të jetë?
- Pret 15 min, pasi ndalon diarrea dhe vendos supostin
 - Mban supostin dhe njofton mjekun
 - I thotë pacientit se do t'ia vendosë supostin kur të dalë nga banja
 - Ia jep supostin nga goja
35. Cila nga keto droga nuk është e ligjshme për përdorim:
- Codeina
 - Sedativët
 - Hipnotikët
 - Heroinë
36. Subsancat inhalatore janë substancat që:
- Përthithen nga lekura
 - Përthithen nga mukoza e hundës
 - Përthithen nga enët e gjakut sublinguale
 - Merren me anë të frymëmarrjes
37. Mjeku përshkroi solucion NaCl 150 ml në orë, i/v tek një pacient me Pneumoni që u pranua në spital me dehidrim të lidhur me Pneumoninë. Sa litra perfusion do të marrë pacienti gjatë turnit të parë 8 orësh?
- 500 ml
 - 2 Litra
 - 1.2 Litra
 - 1.5 Litra

38. Mjeku peditër rekomandon për një femije 5 vjec paracetamol 30 mg/kg peshë në një doze të vetme 4 X në 24 orë. Fëmija peshon 25 kg. Sa mg paracetamol do të administrojë infermierja:
- 30 mg
 - 750 mg
 - 3000 mg
 - 1500 mg
39. 75 ml medikament do të administrohet për 50 min më një sistem të kalibruar me 10gtt/ml. Me sa pika në minutë duhet të vendoset perfuzioni?
- 15 pika ne minute
 - 60 pika ne minute
 - 25 pika ne minute
 - 30 pika ne minute
40. Mjeku urdhëron administrimin IV të 75 mg të një solucionit në një flakon me 100 ml, përqendrimi i të cilit është 25 mg/5 ml . Sa ml duhet të tërheqë infermierja nga flakoni:
- 20 ml
 - 1,5 ml
 - 15 ml
 - 50 ml
41. 20 ml medikament do të administrohet për 20 min, me sistemin 10gtt/ml. Me sa pika në minutë duhet të vendoset perfuzioni?
- 20 pika në minutë
 - 15 pika në minutë
 - 10 pika në minutë
 - 30 pika në minutë
42. Një 75 vjecar u pranua në spital me gjakrrjedhje Gastro-Intestinale. Në kohën e paraqitjes në urgjencë hemoglobina ishte 7.3 g/dl. Mjeku përshkroi 2 qese me masë eritrocitare (125 ml secila) për tu infuzuar brenda 1 ore. Sistemi i administrimit të gjakut në një ml përmban 10 pika (10gtt/ml). Sa do të ishte shpejtësia për minutë e pikave?
- 21 pika ne minutë
 - 42 pika në minutë
 - 60 pika në minutë
 - 120 pika në minutë
43. Ktheni dozat e mëposhtme:
- 0.5g = _____ mg
 - 2.5L = _____ mL
 - 100 mg = _____ g
 - 10 cc = _____ mL

44. Ktheni dozat e mëposhtme:

- a. 250 mcg = _____ mg
- b. 600mL = _____ L
- c. 100 mg = _____ g
- d. 10 cc = _____ mL

45. Mbetjet farmaceutike quhen:

- a. Indet, organet, pjesë të trupit, gjaku dhe lengjet e mbetura pas trajtimit me medikamente ose me metoda kirurgjikale
- b. Mbeturinat farmaceutike të ndotura me lëndë radioaktive
- c. Produktet medikamentoze të skaduara, të papërdorshme, të kontaminuara, të demtuara fizikisht, medikamente dhe produkte që kanë humbur sterilitetin, serumet dhe vaksinat e mbajtura në kushte të papërshtatëshme etj.
- d. Mbeturinat e infektuara, medikamente toksike, kancerogene, lëndet kimike radioaktive.